



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2024:117366

Datë: 20.01.2025

Numri i dokumentit: 06731247

PPP.nr.13/24

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Sabaheta Kurteshi, me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike të permbarimit sipas propozimit për permbarim të kreditorës së permbarimit K.R.M. “Ekoregjioni” sh.a., në Prizren, Rruga “ T. S.” nr..., Njësia Operative në Dragash, Rr.” Dëshmorëve” p.n., kundër debitorit të permbarimit, Z. H. nga fsh..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “K. & Ass.” me avokatët e saj nga Prishtina, Ul. C-..., 2/..., për permbarimin e dokumentëve të besueshme të permbarimit – Kartelës së konsumatorit Nr.- 2010-Z10..., për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 987,34 € (nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë euro e tridhjetë e katër centi) dhe i lejuar me Urdhërin për Permbarim P.nr. 230/24 i dt. 01.03.2024 të Permbaruesit Privat L. H. T. nga Prizreni, duke vendosur sipas prapësimit të ushtruar nga debitori i permbarimit Z. H. nga fsh..., Komuna e Dragashit përmes të autorizuarit të tij kundër Urdhërit për Permbarim, P.nr.230/24 e dt. 01.03.2024 të Permbaruesit L. T. nga Prizreni, jashtë seancës gjyqësore, me dt. 20.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit Z. H. nga fshati..., Komuna e Dragashit dhe Urdhëri për lejimin e permbarimit P.nr.230/24 të datës 01.03.2024, i lejuar nga Permbaruesi Privat L. T. me seli në Prizren, **SHFUQIZOHET** në pjesën që ka të bëjë nga data 30.10.2003 e deri me datë 31.12.2022, për shumën e borxhit prej 928.84 euro, për shkak të parashkrimit të kërkesës.

II. REFUZHET pjesërisht i pa bazuar prapësimi i debitorit Z. H. nga fshati..., Komuna e Dragashit, **MBETET NË FUQI** pjesërisht Urdhri për lejimin e permbarimit me numër P.nr.230/24 të datës 01.03.2024, i lejuar nga Permbaruesi Privat L. H. T. me seli në Prizren, **për shumën e borxhit prej 58.50 euro**, për periudhën nga data 01.01.2023 e deri me datë 23.01.2024, me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së propozimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës permbarimore.

A r s y e t i m

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat L. H. T. nga Prizreni, me urdhrin për përmbarim, P.nr.230/24 të datës 01.03.2024, ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorës së përmbarimit, Ekoregjioni” sh.a. me seli në Prizren të paraqitur kundër debitorit të përmbarimit debitorit Z. H. nga fshati..., Komuna e Dragashit, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 987.34 euro, në emër të shërbimeve publike heqjen e mbeturinave.

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit brenda afatit ligjor është ushtruar prapësimi nga debitori përmes të autorizuarit të tij, në të cilin ka theksuar se: Urdhëri është lëshuar në bazë jo të përshtatshme për përmbarim, ashtu siç parashihet me nenin 27 të LPP-së, kreditori me rastin e parqitjes së propozimit për përmbarim, dokumentin në bazë të të cilit kërkon përmbarimin nuk e ka dorëzuar në original ashtu siç parashihet në bazë të nenit 36 par. 1 të LPP-së. Vlen të ceket se debitori asnjëherë nuk ka pranuar ndonjë faturë lidhur me borxhin e debitorit ndaj kreditorit por vetëm Urdhërin për Përmbarim, andaj konsiderojmë se borxhi i kreditorit është i parashkruar dhe i njëjti nuk mund të realizohet ndërmjet rrugëve gjyqësore – Përmbaruesit Privat ashtu siç parashihet nga neni 71 par.1 pika 1.4 të LPP-së si dhe nenit 360 par. 1 të LMD-së. Andaj i kanë propozuar gjykatës aprovimin e prapësimit të debitorit dhe urdhëri përmbarimor i dhënë në bazë të propozimit të kreditorit të ndalohet dhe të anulohen të gjitha veprimet e kryera, i njëjti të shfuqizohet si i pa bazuar dhe të hidhet poshtë dhe njëherit kreditori të ngarkohet me shpenzimet e procedurës së përmbarimit.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e ushtruar nga debitori dhe ka shtuar se ekstraktet e verifikuara nga librat afariste paraqesin dokumente të besueshme mbi bazën e së cilave mund të inicohet procedurë përmbarimore duke ju referuar nenit 29 të LPP-së par 1 nën par. 1.3, propozimi për përmbarim i plotëson kriteret sipas nenit 27 të LPP-së pra është i përshtatshëm. Po ashtu sa i përket pretendimeve të debitorit për parashkrim, nuk ka mundur të vjetërsohet pasi që debitori nga pagesa vjetore ka pranuar borxh që do të thotë se nuk kemi të bëjmë me parashkrim. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të palejueshëm dhe të LEJOHET përmbarimi sipas propozimit të kreditorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është **pjesërishtë i bazuar**.

Gjykata, fillimisht vlerësoi propozimin për përmbarim të paraqitur nga kreditori dhe erdhi në përfundim se i njëjti është paraqitur konform dispozitës ligjore të nenit 38 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore Nr.04/L-139 (në tekstin e mëtejme LPP-së) dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara me këtë dispozitë, duke ia bashkëngjitur të njëjtit dokumentin e besueshëm në origjinal, në bazë të cilit kërkohen përmbarimi, përkatësisht ekstraktit e verifikuar nga librat afariste, i cili ekstrakt është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim, në kuptim të dispozitave të nenit 29 par.1 nën par.1.2 dhe par.3 të LPP-së, ku përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij lidhi është: 1.1. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesën e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, tutje në paragrafin 3 të këtij nenin parashihet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbarjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar. Gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit në kuptim të nenit 71 par.1 nën par 1.4 të LPP-së, sipas të cilit parashihet se *“ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohej përmbartimi”*, për shumën prej 928.84 euro, pasi që për detyrimet e krijuara prej datës 30.10.2003 deri me datë 31.12.2022, është borxh i parashkruar konform nenit 360 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin theksohet se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpia”*. dhe paragrafit 2 i cili përcakton se *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*. Andaj, për këtë pjesë të borxhit, pasi që kemi të bëjmë me shërbimet publike heqjen e mbeturinave dhe hyn në kategorinë e parashkrimit të kërkesave një vjeçare, gjykata vlerësoi se ka kaluar afati i paraparë me dispozitat e lartcekura - afati i parashkrimit, pas kalimit të së cilit afat, kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore marrë parasysh kundërshtimin e paraqitur nga këtu debitori, andaj edhe vendosi si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendosja në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit si të pa bazuar, pasi që për këtë pjesë të borxhit nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, sepse kreditori e ka ndërprerë parashkrimin duke parashtruar propozim për përmbartim me datën 29.02.2024, bazuar në nenin 369 të LMD-së, ku theksohet se *“Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*. Pra, pjesa e borxhit që përfshin periudhën nga data 01.01.2023 e deri me datë 23.01.2024, në shumë 58.5 euro, ka mbetur në fuqi, pasi që për këtë pjesë nuk ka arritur afati i paraparë për parashkrimin e kërkesës.

Gjykata vlerësoj pretendimin e kreditorit Ekoregjioni lidhur me ndërprerjen e parashkrimit, mirëpo i njëjti pretendim ishte i pabazuar, për faktin se referimi i pagesave të kësteve nuk mund të përfshijë pagesat paushallë në emër të borxhit të përgjithshëm, pasi që termi “këst” iu referohet pagesave të paracaktuara me marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit, e që në këtë rast gjykata nuk u bind vetëm me pretendime deklarative (të pambështetura me prova konkrete). Andaj, në këtë rast gjykata vlerëson se nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit, i paraparë me nenin 368 paragrafi 1 të LMD-së, pasi që ndërprerja e parashkrimit në këto raste bëhet për secilën kërkesë veç e veç, ndërsa pagesat e realizuara sikurse në rastin e debitorit, të njëjtat nuk iu kanë referuar pagesës së ndonjë fature konkrete, veçse nga ana e tij janë bërë pagesa paushalle, andaj në raste të tilla, këto pagesa bëjnë shlyerjen e borxhit të parë të krijuar të debitorit në drejtim të kreditorit, e asesi ndërprerje të parashkrimit, siç edhe është pretenduar nga kreditori.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së. Debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova, sipas nenit 69 par. 4 të LPP-së, i cili parasheh që *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, për ndryshe prapësimi do të refuzohet”*, njëkohësisht kishin të bënin me çështje që paraqitën si bazë ankimore kundër vendimit meritor në procedurë kontestimore.

Andaj nga të cekurat më lartë, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2024:117366, 20.01.2025**

Gj y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.